

TË NXËNËT PËR GJATË GJITHË JETËS: PËRSHTATJE APO PARADIGMË E RE ARSIMORE? LIFELONG LEARNING: ADJUSTMENT OR PARADIGM SHIFT?

MAGDALINI VAMPA

Universiteti "Fan.S.Noli", Korçë, Departamenti i Shkencave Sociale, Bulevardi "Gjergj kastroti" Korçë
Email: magdagaqollari@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Debati mbi të nxënit për gjatë gjithë jetës filloi të fitojë terren në konferenca dhe mjedise akademike, në rajone dhe organizata ndërkombëtare rreth tre dekada e gjysëm më parë. Më 1960, UNESCO deklaroi se edukimi për gjatë gjithë jetës është koncepti kryesor që duhet të drejtojë politikë bërjen, organizimin e arsimit dhe zbatimin e tij. Shumë organizata ndërkombëtare e rajonale, kërkues dhe akademikë kthyen në objekt të punës së tyre edukimin për gjatë gjithë jetës dhe dimensionet që shfaqte ai. Ende sot, zhvillimet e procesit përgjatë përpjekjeve për të aplikuar atë, qëndrojnë në disa çështje të rëndësishme si: edukimi për gjatë gjithë jetës apo të nxënit për gjatë gjithë jetës; edukim i të rriturve apo sistem, paradigme e re arsimore; shoqëria e të nxënit është realitet i kërkuar apo terminologji e politikëbërjes. Rikonceptimi i arsimimit në termat e shoqërisë së të nxënit, shtron dhe dimensionin e shtrirjes së të nxënit për gjatë gjithë jetës, jo vetëm në një institucion dhe jo vetëm në kufij kohorë të caktuar gjatë jetës së individit. Modele të ndryshme të vendeve evropiane dhe jo vetëm, tregojnë se organizmat kryesore ku ata mbështetin këtë vizion të ri, që dikton zhvillimi ekonomik, social dhe kulturor janë Universitetet, të cilët zotërojnë kapacitete për të ndihmuar realitetin e kërkuar.

Fjalët çelës: Edukim për gjatë gjithë jetës, të nxënëtit për gjatë gjithë jetës, roli i universitetit, shoqëri e të nxënit, paradigme arsimore, edukim i të rriturve

Key words: Long life education, long life learning, the role of universities, learning society, paradigm shift, adult education.

HYRJE

"Të nxënit për gjatë gjithë jetës kërkon një program, që të rikonceptualizojë arsimimin plotësisht në përshtatje me parimin se, arsimimi është një proces që zgjat për gjatë gjithë jetës, kërkon një rishikim të plotë të mënyrës të të menduarit për arsimin, një filozofi të re për arsimin, një program të ri veprimi si një koncept zotëruar për të gjithë planifikimet në arsim, për politikëbërësit dhe për ata që venë në praktikë..."¹³ citojme nga raporti i kryetarit të komisionit të UNESCO Faure, mbajtur më Paris, 1972

Pas kësaj deklarate studiuësive u përpoqën të jepnin modelin e edukimit si një pjesë përbërëse të shoqërisë së të nxënit. Ky model do të kërkonte një identifikim të ri të arsimimit, që, do të lejonte përthyerjen nga linjat tradicionale në tre dimensione: në dimensionin e kohës, jo me i identifikuar vetëm me fëmijëri apo deri moshën 20-25 vjet; në dimensionin e hapësirës, jo më në kornizat brenda mureve të shkollës dhe në dimensionin e pedagogjisë, jo vetëm si një aktivitet i mësuesve profesioniste brenda shkollës dhe klasës.

"Shoqëria nuk mund të zhfrytëzohet gjerësisht dhe me një aktivitet eficient në të gjithë komponentet dhe në çdo kërkesë të saj përmes vetëm një institucioni të vetëm, sado gjithpërfshirës të jetë ai".¹⁴

Një nga objektivat i këtij studimi kërkon të sjellë në vëmendje rëndësinë e trajtimit të të nxënit për gjatë gjithë jetës si një sistem, paradigme të re arsimore, kur shoqëria sfidon zhvillimet e shpejta ekonomike dhe kërkon të përcaktohet si shoqëri e dijes dhe kompetitive. Argumenta teorike në testim të kësaj hipoteze vijnë nga disa studiuësive të cilët vlerësojnë modelin japonez të sukseshëm edhe pse për shumë vende perëndimore qëndron utopi.

¹³ International Handbook of Lifelong Learning, volume I, fq.xvii

¹⁴ (Faure 1972, pp.161-162)

Objektivi tjetër synon të paraqesë në disa vlera ndjeshmërinë e universitetit shqiptar në rolin që nismat ligjore dhe vetë shoqëria po paraqet në dyert e tyre.

Koncepti i edukimit dhe të nxënimit për gjatë gjithë jetës.

“Edukim për gjatë gjithë jetës”, paraqet një sistem, i cili i siguron një personi mundësi për zhvillimin individual në nivelet më të larta të potencialit të tij dhe përfshin arsimimin formal nga kopshti deri në studimet universitare dhe ato pasuniversitare por dhe gjithë mundësitë e arsimit të individit gjatë jetës së tij, në një lidhje të ngushtë me interesat, detyrat dhe nevojat e tij.

Periudha e parë e kësaj lëvizjeje, starton me vitet 1960-70 dhe koncepti përkrahet nga dy organizata ndërkombëtare UNESCO dhe OECD. UNESCO shihte evoluimin e “edukimit për gjatë gjithë jetës” si një integrim horizontal të arsimit dhe jetës. Ky sistem sjell ndryshime në zhvillimin e individëve nga pikpamja humaniste por, duke nënvizuar dhe anën pragmatike të problemit, progresin e ekonomisë.

Gjatë *periudhës së dytë* pas stanjacionit të viteve '80, shohim përdorim e konceptit¹⁵ në mbështetjen dhe marrjen e atyre shkathtësive e kompetencave për zhvillimin e mundësive të përgjithshme dhe specifike të individët, që lidhen parësisht ose dhe krejtësisht me zhvillimin ekonomik dhe dinamikën e ndryshimeve.

Një *periudhë të tretë*¹⁶, që starton në vitet 2000 e në vazhdim, e lidhur kjo, kryesisht me përvojën në Europë. Memorandumi i Edukimit për Gjatë Gjithë Jetës i Bashkimit Europian (2000)¹⁷ vendos dy qëllime të rëndësishme dhe ekuivalente, *promovim të qytetarisë aktive dhe të punësimit*. “*Bashkimi Europian duhet të vendosë një shembull për botën duke treguar se është e mundur të arrihet rritja dinamike e ekonomisë dhe njëkohësisht të forcohet kohezioni social.*”

Nga perspektiva ekonomike të nxënimit për gjatë gjithë jetës është i dobishëm dhe më shumë se i dobishëm, për disa qëllime themelore, thellësisht i lidhur me punësimin dhe politikën ekonomike¹⁸, por është dhe një proces i dobishëm dhe për vetë brendësinë e individit.

Të nxënimit për gjatë gjithë jetës dhe shoqëria e dijes. Modeli japonez përballë atij perëndimor.

Shoqëria e dijes apo e të nxënimit shumë e përmenduar si një nga parimet ose konceptet bazë në dokumentet e organizmave përgjegjës të zhvillimeve, duhet vlerësuar si çelës i çdo lëvizjeje dhe projekti që do të udhëheqë edukimin për gjatë gjithë jetës.

Japonia është i pari vend që rishikon më mënyrën e duhur këtë koncept më herët se vendet perëndimore. Në 1990 vendos në politikën e saj kombëtare krijimin e shoqërisë së dijes dhe përgjegjësitë për të realizuar u ndërmorën nga Parlamenti, me Këshillin Kombëtar të Nxënimit për Gjatë Gjithë Jetës. Qeveria Japoneze me politikën e veta suportoi cdo iniciativë lokale të edukimit që kontribuonte në të nxënimit për gjatë gjithë jetës duke cilruar asistencë financiare në projektet e tyre, në heqjen e taksave¹⁹ dhe politika të tjera të ngjashme. Gunther Dohman¹⁹ vëren se pika primare ku Japonia nisi politikën e saj, ishte progresi i të nxënimit jo-formal në kontekstin e jetës së përditshme. Kjo u quajt *shakai kyoiku* që fjalë përfjalë do të thotë të nxënimit social dhe të nxënimit në shoqëri. Principi i punës në Japoni, u bazua në njohjen e vlerave që do të sillnin të gjithë format e të nxënimit, formale e joformale si një pjesë e një network-u të përgjithshëm për të nxënimit në shoqërinë e vendit. Dohman i referohet 17.000 *kominkaneve*, qendrave të të nxënimit të cilat siguronin bashkëpunim më institucionet publike, kompanitë private, shtëpitë botuese, stacionet televizive e në vazhdim, krijonin hapësira të reja për “nxënësit e shoqërisë së dijes”. Po ky autor nënvizon përfshirjen shumë të dobishme të teknologjisë së komunikimit në krijimin e qendrave të komunikimit elektronik privat dhe publik.

Është fakt se Këshilli Kombëtar i të Nxënimit për Gjatë Gjithë Jetës, u kufizua në interferimin e tij për kanalizimin dhe drejtimin e aktivitetit të individëve sipas pragmatizmit të zhvillimit kombëtar. Të nxënimit për gjatë gjithë jetës duhej të buronte së brendëshmi nga jeta e secilit, nga eksperiencat dhe interesat personale, dhe jo vetëm nga origjina të jashtme. Më së shumti kjo duket utopike, pasi mbledhja e kërkesës dhe planifikimi i ifrastrukturës është i vështirë kur lejohet spontanitet në kërkesën për edukim për gjatë gjithë jetës.

Por, si Dohman dhe Makino²⁰ vërejnë se Japonia diti të zgjidhë sic duhet, e pati sukses në të kthyerin e shoqërisë në shoqëri të dijes. Kjo u vu re në arritjet e para të viteve 2000, ku shoqëria Japoneze u identifikua me moshën e informacionit dhe si një shoqëri e maturuar.

¹⁵ International Handbook of Lifelong Learning, volumni I, fq.276

¹⁶ Dimensions of Adult Learning

¹⁷ Dimensions of Adult Learning, fq.154 -155

¹⁸ International Handbook of Lifelong Learning, volume I fq. xx

¹⁹ International Handbook of Lifelong Learning, volumni I, fq.189

²⁰ Recent Developments in Japan's Lifelong Learning Society, 1997 fq.2

Në perëndim, janë pikërisht vitet 1990, vetëm pak vite më vonë se Japonia, që vendosën si temë diskutimi nevojën e zhvillimeve për shoqërinë e të nxënit. Ndryshimi ishte se jo shtete dhe organizmat qeverisës por ambienti i biznesit dhe industrisë inicioi lëvizjet e para dhe argumentoi nevojën e mbështetjes mbi këtë koncept lëvizës. The European Round Table of Industrialists (ERT), e mbledhur në Bruksel 1994, publikon raportin *Education for Europeans, Towards the learning Societ*, nga citojmë “Standartet shkollore që siguron sistemi i sotëm arsimor Europian është afërsisht i gjithi i pasinkronizuar me zhvillimet bashkëkohore... këto diferenca janë duke vendosur konkurrencën Evropiane dhe idealet e demokracisë në risk dhe madje është duke ushqyer papunësinë dhe marxhinalizimin social”²¹

Në 1995, Komisioni Europian publikon White Paper ²² *Mësimi dhe të nxënëtit – drejt shoqërisë së të nxënit* ku shpallte “lindjen” e shoqërisë së të nxënit. Dokumenti vendos pesë objektiva në udhën për të ndërtuar Evropën e dijes: (1)përvetësim të dijeve të reja, (2)bashkëpunim i ngushtë i biznesit dhe shkollës, (3)mundësive të reja duke kundështuar problemet e përjashtimit, (4)aftësi për përdorimin e tre gjuhëve kryesorë në komunitet dhe (5)trajtimi i kapitalit investues dhe investimeve në trajnim në mënyrë të barabartë.

Kjo mënyrë e konceptimit të Evropës së dijes është e lidhur ngushtë me parimet sociale dhe ekonomike por objektivi aq i dukshëm në projektin e qeverisë Japoneze mbi atë që quhet vetëpërbushje personale, nuk duket në asnjë nga këto objektiva. Është e dukshme se këto orientime ideologjike, këto rekomandime të qarta nuk pretendojnë për një paradigmë të re në mënyrën e të menduarit rreth arsimimit.

Në kontekstin e çështjes që vetë titulli prezanton, duhet të nënvizoj përpjekjet e Britanisë për përfaqje sipas modelit japonez. Sekretari i Shtetit për Edukimin²³ identifikon “*dy iniciativa të cilat do të suportojnë ndjeshëm qasjen tonë drejt shoqërisë së re të dijes, ...ngritja e llogarive individuale të të nxënit do t'i lejonte gjithsecilit marrjen e përgjegjësive nga suporti i dhënë nga qeveria apo punëdhënësit; ngritja e 'Universitetit të Industrisë' i cili do të ofronte akses të gjithë individëve që do të donin të thellonin njohuritë ,*

²¹ International Handbook of Lifelong Learning, volumni I, fq.189

²² International Handbook of Lifelong Learning, volumni I, kapitulli 12, Kenneth Wain, fq.291

²³ Secretary of State for Education and Employment, (1998), *The Learning Age: a renaissance for a new Britain*, HMSO, London

të rifreskonin aftësitë dhe të fitonin të reja ... Biznesi duhet të lëvizte dhe të afronte investimin dhe kërkesën e vet tek universitetet që do t'u shërbenin nevojave ... e ndryshimit të pritsëm të sipërmarrjes së tyre, deri sa të identifikonin qënien e tyre si organizata të të nxënit”.

Roli i universitetit shqiptar në këtë lëvizje drejt shoqërisë së të nxënit.

Sfidat e universitetit sot identifikohen në tre²⁴: (1)sa mirë do tu përgjigjen zgjedhjeve të `klientëve`, (2)si duhet të plotësohen nevojat e atyre që aktualisht nuk u është shërbyer, (3)cili do të jetë drejtimi që qeveria do t'i japë sistemit të edukimit terciar dhe si do të konsiderojë rolin e universitetit brenda këtij sistemi.”

Deklarata e Sorbonës 25 maj 1998, nënvizon:“*Ne po shkojmë drejt një periudhe ndryshimesh të mëdha në fushën e arsimit e të kushteve të punës me një shumëllojshmëri kursesh për kariera profesionale, ku arsimimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm përbën një obligim të qartë”.*

Në raportin e Konferencës të Ministrave Përgjegjës për Arsimin e Lartë, Berlin 2003, midis të tjerash nënvizohet: “*duhet të vlerësohet kontributi i rëndësishëm i arsimit të lartë në bërjen e arsimit për gjatë gjithë jetës një realitet”.*

Duke përmbledhur: ndikimi i Reformës Evropiane të Arsimit të Lartë, përpjekjet e gjithanshme për implementimin e saj në vendin tonë, shikimi kritik i realitetit tonë, në drejtim të filozofisë së edukimit për gjatë gjithë jetës, kushtet favorizuese ligjore të parashikuara në Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri, janë shtysat për konturimin e fushës së studimit të këtij punimi. Fusha e studimit të edukimit të të rriturve, nën filozofinë e “arsimimit për gjatë gjithë jetës”, çoi tek çështjet e analizës së domosdoshmërisë të këtij formimi dhe të çështjes së veçantë të kërkimore, se ç'rol duhet të luajnë universitetet në këtë aspekt.

- Kryerjen e një sondazhi në terren në mjediset universitare në vend për të evidentuar perceptimet, mentalitetet apo stereotipet e stafeve akademike për çështjen e edukimit për gjatë gjithë jetës, dhe rolit që duhet të kenë këto institucione.

- Kryerjen e një analize të dhënash bazuar tek informacioni cilësor dhe statistikor duke kombinuar metodat e analizës statistike dhe asaj cilësore.

Në fazën e konceptualizimit të studimit përcaktova edhe një grup çështjesh, që orientuan kërkimin:

- Ç' duhet kuptuar me nocionin “edukim i vazhduar dhe për gjatë gjithë jetës”?

²⁴ International Handbook of Lifelong Education; Volum II, C. Duke, fq. 505

- A është i domosdoshëm “edukimi për gjatë gjithë jetës” në Shqipëri?
- A mund të luajnë një rol parësor universitetet dhe shkollat e larta në këtë proces, në Shqipëri?
- A mund të ketë vështirësi implementimi i “formimit të vazhduar” në realitetin shqiptar?
- Një grup çështjesh shtrojnë problemet e realizimit dhe përmbushjes së kushteve; intelektuale dhe të përgatitjes së personelit, mjeteve financiare, mjeteve materiale e didaktike, dispozitat ligjore etj, për formimin e vazhduar.
- Grupi i fundit i çështjeve sillen rreth kategorive “të formimit të vazhduar”, formave strukturore më të përshtatshme për realizimin e tij, si dhe njohjes së kërkesës për këtë formim.

Për organizimin e mbledhjes së informacionit nëpërmjet sondazhit në terren me anën e një pyetësoi të strukturuar, u bë edhe zgjedhja e kampionit. Popullsia e marrë në studim përbënte shtresën e personelit mësimdhënës në universitete, përafërsisht 2000 subjekte. Në pikpamjen e këtij studimi kjo shtresë konsiderohet si homogjene pavarësisht nga diferencat moshore, gjinore, kualifikimi akademik, përvojës, rolit në drejtim, etj.

Konceptimi i këtij sondazhi në terren, mbante parasysh sigurimin e një informacioni kryesisht sasior, të përcaktuar dhe strukturuar sipas shkallëve të masës ordinale, intervale dhe asaj të Likertit, të cilat mundësuan një analizë statistike të dhënash, i cili u mbledh nga një kampion i thjeshtë rastësor me madhësi 100 subjekte të shpërndara në 5 Universitete në Shqipëri.

- Universiteti i Korçës 25 subjekte,
- Universiteti i Gjirokastrës 25 subjekte,
- Universiteti i Elbasanit 20 subjekte,
- Universiteti i Shkodrës 15 subjekte,
- Universiteti i Tiranës (Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës) 15 subjekte.

Sondazhi u krye gjatë muajve, dhjetor 2007- janar 2008, duke shpërndarë pyetësorët e përgatitur për këtë qëllim, të plotësuar sipas preferencës dhe mendimit të çdo subjekti.




Fig1

Disa prej tyre mendoj t'i paraqes në ilustrim të argumentit të mësipërm.

Nga 95 % e subjekteve të intervistuar, që mendonin se shoqëria po kërkon shërbime të tjera, 96% e tyre mendojnë se, edukimi për gjatë gjithë jetës është një nga këto shërbime dhe risi e universitetit tonë, fig 1.

- 39,1% pedagogë të intervistuar, shohin etjen për përfeksionim dhe kualifikim profesional si kërkesën më të domosdoshme të individëve në shoqërinë tonë.
- Ndërsa 37,8% prej tyre mendojnë se kërkesa po drejtohet për rikonvertim profesional në përgjigje të tregut të punës.
- 12,8% e shohin si një kërkesë për t'u pajisur me një diplomë të re,
- 10,3% mendojnë se individët po kërkojnë të marrin njohuri për të kënaqur veten dhe për të rritur nivelin e tyre kulturor.




Fig.2

Shifrat mund të interpretohen duke besuar se sfida e zhvillimeve dhe nevoja për t'a përballur atë është kërkesa, që sot troket më së shumti para mureve “të katedrales”, pra kualifikimi profesional e madje dhe rikonvertimi profesional, janë kërkesat më të domosdoshme të shoqërisë.

Rreth 96% të pedagogëve shohin pengesa në apikim të procesit.

Nisur nga të dhënat statistike shohim se pengesë kryesore, vlerësohet vështirësia në evidentimin e kërkesës për formim plotësues.

- 28% e të intervistuarve vlerësojnë se, mbledhja e kërkesës n.q.se ekziston, është e vështirë për t'u realizuar nga universiteti.
- 18% e subjekteve shohin se, pengesë kryesore janë burimet financiare që do të mbulojnë këtë process, do të jetë buxheti, bizneset e interesuara, individët apo burime të huaja.
- 17% mendojnë se kompetencat e stafit janë të pamjaftueshme përballë kërkesave për edukim për

gjatë gjithë jetës. Kompetencat e kërkuara në realizim të suksesshëm të procesit kërkojnë prej pedagogëve, aftësi e shkathtësi ndërdisiplinore, programe të integruar, modele të reja didaktike bazuar në shkencën e andragogjisë.

- 15% mendojnë se pengesë është mungesa e strukturave universitare, të cilat do të marrin përsipër, gjithë organizimin e këtij procesi kompleks.

- 12% shohin pengesë infrastrukturën e pamjaftueshme të universiteteve tona, e cila vuan nga mungesë ambientesh, apo dhe teknologjie që i nevojitet fleksibilitetit të kërkuar prej këtij procesi dhe “klientëve” të tij.

- 10% mendojnë se për stafin akademik kjo do të jetë një ngarkesë suplementare që mund të mos menaxhojë dot realizimin e edukimit për gjatë gjithë jetës.




Fig.3

100% e subjekteve mendojnë se duhen krijuar kushte. Është e dukshme që, pedagogët shohin të rëndësishme gatishmërinë e tyre në veçanti dhe të institucionit në përgjithësi. Në aplikim të procesit të edukimit për gjatë gjithë jetës, duhen aftësi e shkathtësi të reja, hapësira dhe mundësi që lejojnë mbarëvajtjen e tij.




Fig.4

- 47% e subjekteve vlerësojnë se, vullneti pozitiv i universitetit është një nga kushtet që përcakton suksesin në realizimin e procesit.
- 14% e të intervistuarve mendojnë se mjetet intelektuale, pra kompetenca të reja jo vetëm të specialitetit, por dhe njohuri mbi pedagogjinë e të rriturve, janë kushte që duhet të paraprijnë dhe të ecin me edukimin për gjatë gjithë jetës.
- 10% mendojnë se janë dispozitat ligjore ato që duhet t'i paraprijnë kësaj sipërmarrjeje dhe të hapin mundësitë e realizimit të saj nga universitetet.
- 6% mendojnë se disponueshmëria e kandidatëve gjatë kohës së realizimit të procesit duhet të modelohet në lidhje me përgjegjësitë e tyre (kandidatëve) dhe të vetë stafit të pedagogëve.
- 5% vlerësojnë mjetet materiale si një kusht që duhet të ndryshojë për të ndihmuar në aplikim të procesit, siç janë laboratorët, mjetet ndihmëse audio e video.

- Ndërsa vetëm 4,9% mendojnë se intervista është një teknikë për mbledhjen e evidencave të kërkesës.

PËRFUNDIME

Në kohën kur studiuesit ngrenë çështjen se vendet Evropiane synojnë drejt një paradigme të re arsimore si në Japoni apo përqipen për përshtatje pragmatike në shërbim të zhvillimeve ekonomike, vërehet se në vendit tonë përgjegjësia për të inicuar dhe transmetuar në çdo hallkë të sistemit edukues sot troket në dyert e Universiteteve.

Disa rekomandime që pasuan këtë analizë po i rendis:

- Inicimin e një debati publik mbi edukimin për gjatë gjithë jetës, dhe trajtimin e tij si një paradigme të re arsimore.

- Hartimin i projekteve, të programeve, e kurrikulave të tilla që të plotësojnë pritshmëritë e "klientëve", nga ana e institucioneve të Arsimit të Lartë.

-Kualifikim të mëtijshëm të stafit universitar në marrjen dhe zotërimin e kompetencave të reja në trajtimin e arsimit të të rriturve në përputhje me veçoritë e tyre.

-Pajisjen e universiteteve me mjete materiale dhe shfrytëzimin e teknologjisë së informacionit, si një mjet të domosdoshëm në shërbimin ndaj studentëve të rritur.

-Krijimin e qendrave të edukimit të vazhduar brenda juridiksionit të universitetit.

-Bashkëpunim dhe krijim të partneriteteve me universitete në vende të tjera të cilat kanë përvojë në aplikimin e edukimit për gjatë gjithë jetës si një sistem të ri arsimor dhe shërbim të ri të universiteteve.




Fig.5

- 41,5% e subjekteve të intervistuar mendojnë se, universiteti duhet të kontaktojë dhe të jetë sa më pranë të qenit universitet rajonal në marrdhënie të ndjeshme me biznesin, dhe institucione të tjera si organe të qeverisjes lokale etj.

- 23,2% prej tyre vlerësojnë se, anketa e vlerësimit të nevojave potenciale është një mjet për të evidencuar kërkesën. E gjithë kjo mund të realizohet në projekte të ndryshme kërkimore që universiteti duhet të ndërmarë gjithnjë në shërbim të komunitetit.

- 20,7% e subjekteve mendojnë se universiteti duhet të gjejë forma të tilla komunikimi me individët për të qënë në gjendje të kontaktojë e vlerësojë nevojat e tyre para sfidave të jetës.

- 9,8% e tyre, japin komente të tjera si, shpallja e ofertës së uiversitetit, duke qënë ky një institucion i specializuar që ka aftësi të dallojë tendencat e tregut të punës dhe të përcaktojë tërësinë e kompetencave të nevojshme për individët duke i orientuar ata.

BIBLIOGRAFIA

1. International Handbook of Lifelong Learning, Maj 2001, Kluwer Academic Publishers, Dordrecht, Holland.

2. Dimensions of Adult Learning, Griff Foley, England, 2004.

3. Lifelong Learning and the New Educational Order, John Field, Trentham Books UK 2006.

4. Secretary of State for Education and Employment, (1998), The Learning Age: a renaissance for a new Britain, HMSO, London

5. Makino, A. Recent Developments in Japan's Lifelong Learning Society, 1997,

apcc-hurdit.org/lifelong-learning-book/makino.html

6. Lifelong Education: Opportunities and Obstacle, E. Gelpi International Journal of Lifelong Education, Volume 3, Issue 2 April 1984, pages 79 – 87.

7. Constructing International Policy Research: the role of CER/IOECD. Tom Schuller, European Educational Research Journal, Volume 4, Number 3, 2005,

www.worlds.co.uk

8. Prof.dr.Gj. Pendavinji dhe M.Gaqollari, Mbi nevojën e formimit plotësues dhe roli i universitetit, Buletinin Shkencor, nr.12, 2006, Universiteti "F.N.Noli", Korçë
9. Deklarata e Përbashkët e Ministrave Evropianë të Arsimit bërë në Bolonjë më 19 qershor 1999: Hapësira e arsimit të lartë Evropian
10. Deklarata e Sorbonës e 25 majit të vitit 1998
11. Njohja në Hapësirën e arsimit të Lartë Evropian. Një rend dite për 2010. Raporti i Lewis Purser-it, Raportues i Përgjithshëm i Shoqatës Universitare Evropiane.
12. Raporti i Konferencës së Ministrave Përgjegjës për Arsimin e Lartë, Berlin 2003,
13. Ligji Nr.9741 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë të aprovuar nga Kuvendi i Shqipërisë në Nëntor 2007
14. Projekt Master Plani për Arsimin e Lartë, MASH, 2006.
15. "Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004-2015" Qershor 2004.
16. European Union, November 1993 Commission White Paper on Education and Training - Teaching and Learning - Towards the Learning Society. COM (95) 590 final, 29 November 1995